



### KONTRATE SHITJE

Ne Tirane sot me daten 15.07.2005( Korrik dymije e pese) para Meje Noteres Publike Dhimitra Qarri e regjistruar prane Dhomes se Noterise Tirane me Zyre noteriale perballe Gjykates se Shkalles se pare Tirane, u paraqiten personalisht palet

### PALA SHITese

Fatmir Elezi, i biri i Muharremit, i datelindjes 01.01.1954, banues ne Gjepalaj-Durres, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta nr 1897566.

### PALA BLERese

Ilir Ndraxhi, i biri i Muhametit , datlindja 28.01.1964, lindur ne Durres, banues ne Shijak Durres, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta nr 0901009, te dy madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar te cilet me vullnetin e tyre te lire dhe te plote me kerkuar mua Noteres hartimin e kesaj kontrate shitblerje aksionesh si me poshte .

Pala shitese z Fatmir Elezi eshte aksioner ne shoqerine "PRODHIME METALIKE " sh.a Shijak pas ndarjes, e regjistruar si e tille me vendimin e Gjykates se shkalles se Pare Tirane nr 29193, date 28.06.2002, me seli ne Shijak, zoterues 17.34% te kapitalit themeltar te shoqerise baraz me 2004 aksione.

Asambleja e aksionereve te shoqerise "PRODHIME METALIKE " sh.a Shijak, pas ndarjes, me vendimin nr. 2, date 28.06.2005 ka vendosur me unanimitet pranimin e kerkeses se z. Fatmir Elezi, per t'i shitur z. Ilir Ndraxhi i cili nuk eshte aksioner i shoqerise, 17.34% te kapitalit themeltar te shoqerise baraz me 2004 aksione duke u larguar keshtu nga shoqeria. Ilir Ndraxhi eshte dakort te bleje 17.34% te kapitalit themeltar te shoqerise baraz me 2004 aksione nga z. Fatmir Elezi.

Cmimi i shitjes se aksioneve te mesiperme i caktuar me mareveshje te paleve eshte 3 900 000 leke (tremilion e nente qindmije).

Pagesa e vleres prej 3 900 000 leke (tremilionenenteqindmije), nga bleresi ne favor te shitesit u be sot ne daten e lidhjes se kontrates, jashte kesaj zyre noteriale .Pala blerese eshte plotesisht dakort qe ti bleje keto aksione me kushtet e vena sa me sipër nga pala shitese; duke blere aksionet e mesiperme te shoqerise me gjendjen e aktivitetit dhe te pasivit te saj deri ne daten e lidhjes se kontrates sipas perqindjes per bleresin dhe behet zoterues ne kapitalin themeltar te shoqerise 2004 te aksioneve te shoqerise "PRODHIME METALIKE " sh.a Shijak, pas ndarjes.

Kontrata hartohet ne baze te nenit 746, 705 e vijues te K.Civil ne fuqi dhe ligjit 7638,,Per shoqerite tregtare" date 19.11.1992.Pasi iu lexua paleve me ze te larte, u gjet e rregullt sipas deshires dhe vullnetit te lire e te plote, nenshkruset rregullisht prej tyre para meje noteres dhe une noterja e vertetoj ate .

BLERES

P A L E T

SHITES

Ilir Ndraxhi  
AT

Fatmir Elezi

Fatmir Elezi